




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



Drejtoria Komunale e Arsimit

Nr. _____

Datë: 18.09.2025

Në bazë të nenit 23 të Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, neni 11 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2016 për Aktivitetet Jashtëshkollore, Komuna e Mitrovicës së Jugut, shpall:

K O N K U R S

(për përzgjedhjen e agjencisë së udhëtimit të nxënësve për ekskursion jashtë vendit - Shqipëri)

I. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim të agjencioneve turistike:

- Formulari i aplikimit (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë);
- Licenca e Agjencionit turistikë;
- Çertifikata e agjencionit transportues;
- Dëshmia e kontrollimit teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore rrugore;
- Agjencioni duhet të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollave;
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasëve të autobusëve;
- Agjencioni duhet të sigurojë perkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi (çertifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Autobusët duhet të jenë komfor dhe me klimë;
- Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së agjencioneve turistike:

Përzgjedhja e agjencioneve turistike do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2016, dhe sipas kërkesave të shkollave.

III. Shkollat të cilat kanë bërë kërkesë për ekskursion janë:


- SHML Gjimnazi "Frang Bardhi" numri i nxënësve dhe mësimeve afërsisht (300-330), Prej datës 03.10.2025 deri 07.10.2025 vendi Shqipëri;
- SHMLM "Dr. Xheladin Deda" numri i nxënësve dhe mësimeve afërsisht (300-330) Prej datës 29.09.2023 deri 03.10.2025 vendi Shqipëri;

- SHMLE ''Hasan Prishtina'' numri i nxënësve dhe mësimdhënësve afërsisht (170-200)
Prej datës 03.10.2025 deri 07.10.2025 vendi Shqipëri;
- SHMLT ''Arkitekt Sinani'' numri i nxënësve dhe mësimdhënësve afërsisht (130-160)
Prej datës 29.09.2023 deri 03.10.2025 vendi Shqipëri;

IV. Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 7 ditë nga data e publikimit të konkursit më 19.09.2025 deri më datën 25.09.2025 që konsiderohet si dita e fundit dhe mbyllja e konkursit;

Dokumentet e dërguara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen nga Komisionet.
Konkursi publikohet edhe në ueb-faqe zyrtare të Komunës: <https://kk.rks-gov.net/mitrovicjeejugut/>


 Drejtoria e Arsimit
 Drejtore Drita Kadriu

